

Ekskluzive

Ekskluzive | Krismat në aheng familjar alarmojnë Policinë – ky është 23-vjeçari që pranoi se shtiu, sekuestrohen arma dhe 31 gëzhoja



Sinjali.com

30 Gusht 2026 12:44



Një aheng familjar në Prishtinë ka marrë vëmendjen e Policisë të shtunën mbrëma, pasi në zonë janë dëgjuar të shtëna me armë, raporton ekskluzivisht Sinjali.

Ngjarja ka ndodhur më 29 gusht, rreth orës 21:30, në rrugën “Osumi” në Prishtinë.

Burimet e Sinjalit bëjnë me dije se personi i dyshuar është **Fuad Berisha**, 23-vjeçar, i cili është identifikuar pasi njësitë policore intervenuan në lokacion.

Policia fillimisht kishte pranuar informacion për të shtëna me armë zjarri. Me të mbërritur në vendngjarje, zyrtarët policorë kanë konstatuar se aty po zhvillohej një aheng familjar.

Gjatë kontrollit të zonës janë gjetur disa gëzhoja, si dhe një armë me gaz.

Hetimet e para kanë çuar te Berisha, i cili, sipas informacioneve që ka Sinjali, ka pranuar se kishte shtënë me armë dhe ka deklaruar se arma ishte në pronësi të tij.

23-vjeçari është shoqëruar në stacion policor, ku është intervistuar në praninë e avokatit mbrojtës.

Në vendngjarje kanë dalë edhe Njësia e Hetimeve dhe Forenzika, të cilat kanë kryer ekzaminimet dhe procedurat përkatëse.

Si prova materiale, Policia ka sekuestruar armën, një karikator dhe 31 gëzhoja, të cilat do t’i nënshtrohen ekzaminimit të mëtejshëm.

Për rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit, i cili ka udhëzuar që ndaj 23-vjeçarit të iniciohen rastet për “Përdorim të armës” dhe “Armëmbajtje pa leje”.

Pas përfundimit të intervistimit dhe procedurave policore, Berisha është liruar në procedurë të rregullt.

Rasti vazhdon të trajtohet nga organet kompetente.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

31 gëzhoja

ekskluzive

krisma ne aheng familjar

sekuestrohet arme

Sinjali

Të tjera:

Presidenti finlandez: Rusia nuk do të rrezikonte ta sulmonte NATO-n

Evropë

Jesus largohet nga Arsenali, pritët të nënshkruajë me Barcelonën

Futboll

Spanja ndan 165 milionë euro për rimëkëmbjen e Ceutës pas fluksit të migrantëve

Botë

Siri do të shohë atë që shihni ju: Apple përgatit syzet inteligjente për vitin 2027

Teknologji

Alarm për higjienën në Kirurgjinë Vaskulare: Pacienti rrëfen për Sinjalin se çarçafët e...

Kosovë

WhatsApp teston funksionin e ri që paralajmëron përdoruesit për...

Aplikacione

Përmbysjet trageti me 267 persona pranë Qipros

Botë

Autobusi përfshihet nga zjarri në Shkup, nuk raportohet për të lënduar

Rajon

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera